

Për dijeni:

**AGJENCISË KOMBËTARE TË FINANCIMIT
TË ARSIMIT TË LARTË**

Rr: "Naim Frashëri" Nr.37, Tiranë

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është miratuar vendimi nr. 386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", i cili parashikon në pikën 8, se ministri përcakton rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit.

Në zbatim të këtij udhëzimi është miratuar udhëzimi nr. 30 datë 04.11.2022 "Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar", të cilin jua përcjellim për zbatim dhe për marrjen e masave për të informuar studentët, për të aplikuar sipas një formulari model të cilin, jua vëmë në dispozicion për referencë, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për rezultate të shkëlqyera apo ndjekjes së programeve prioritare, do të bëhet nga studentët pranë AKFAL-it, deri në datën janar të vitit 2023. Aplikimi do të bëhet sipas formularit, të cilit do t'i bashkëngjiten dokumentet provuese, origjinal ose kopje të noterizuara, sipas përcaktimeve të udhëzimit të sipërcituar.

MAS ju kërkon që të bashkëpunoni me Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë lidhur me procesin e aplikimeve dhe të informoni studentët që plotësojnë kriteret dhe që pranojnë kushtet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, për të përfituar mbështetje financiare, si dhe qartësimin e procedurave të mbështetjes financiare të studentëve, si dhe shmangien e çdo paqartësie në zbatimin njëkohësisht të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar dhe të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

EVIS KUSHI

